

Datë _____.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“MIRËMBAJTJE Pjesë këmbimi, GOMA DHE BATERI (ME 2 LOTE) ” , TË NDARË SIPAS LOTEVE:

LOTI 1 : “ MIRËMBAJTJE, Pjesë këmbimi DHE BATERI PËR MJETET E LEHTA DHE ZJARRFIKËSET”

LOTI 2 : “Pjesë këmbimi, GOMA DHE BATERI PËR MJETET E RËNDA”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34900000-6 PAJISJE TË NDRYSHME TRANSPORTI DHE Pjesë këmbimi

VLERA E FONDIT LIMIT:

7 083 332,00 (SHITATË MILION E TETËDHJETË E TRE MIJË E TRE QIND E TRIDHJETË E DY) LEKË, PA TVSH, PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT ME OBJEKT “MIRËMBAJTJE,Pjesë këmbimi, GOMA DHE BATERI (ME 2 LOTE)”, TË NDARË SIPAS LOTEVE:

LOTI 1 : “ MIRËMBAJTJE, Pjesë këmbimi DHE BATERI PËR MJETET E LEHTA DHE ZJARRFIKËSET”, ME FOND LIMIT 3 050 000 (TRE MILION E PESDHJETË MIJË) LEKË PA TVSH.

LOTI 2 : “Pjesë këmbimi, GOMA DHE BATERI PËR MJETET E RËNDA” , ME FOND LIMIT 4 033 332 (KATËR MILION E TRIDHJETË E TRE MIJË E TRE QIND E TRIDHJETË E DY) LEKË PA TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Finiq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1 : “ MIRËMBAJTJE, Pjesë këmbimi DHE BATERI PËR MJETET E LEHTA DHE ZJARRFIKËSET”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.2 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare 2022, 2023, 2024 në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon (të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar), në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij financiar-ekonomik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël***

arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon, në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij teknik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 55 dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 55 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ”Liqence profesionale Kodi VII.3.B.1” të lëshuar nga Qendra Kobetare e Biznesit (QKB) për veprimtarite:

VII.3.8.1/a – Riparim dhe mirembajtje e pjeseve mekanike dhe te motorit, te mjeteve.

VII.3.8.1/b – Riparim dhe mirembajtje e karrocere ,te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.8.1/c – Riparim dhe mirembajtje e impiantit elektrik te mjeteve rrugore me motore dhe rimorkiove.

VII.3.8.1/ç – Riparim dhe mirembajtje e gomave te mjeteve rrugore me motore dhe rimorkiove.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe në zbatim të Ligjit Nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, neni 4, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, duke siguruar AK që shërbimet objekt prokurimi do të realizohen nga subjekte që respektojnë legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor dhe për normat e kujdesit ndaj mjedisit, ndaj ndotjeve dhe parandalimit të dëmtimeve dhe që janë të regjistruara sipas këtij ligji.

Liçenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter më sipër është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 2 (dy) persona, për periudhën muajin e fundit vërtetuar me:

- a.** Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën muajin e fundit.
- b.** Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën muajin e fundit shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Sa i perket numrit te punonjesve, kjo kërkesë është shumë minimale dhe e lidhur ngushte me nevojën e përballimit te mbajtjes ne gatishmëri te mjeteve. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personeli i nevojshem referuar shërbimeve të nevojshme për automjetet , për realizimin e kontratës në mbështetje të dispozitave të sipërpermendura sepse nëpërmjet këtij kriteri bëhet përcaktimi nga ana e operatorit ekonomik e listës së personelit të nevojshëm dhe të domosdoshëm që do të ndjek zbatimin dhe realizimin e kontratës, në përputhje me specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit** për mjetet në rastet e difekteve nga adresa e autoritetit kontraktor deri në servis, si dhe të pjesëve të këmbimit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Duke qenë se autoriteti kontraktor nuk disponon mjet për transportin e tyre në rast difekti, dhe me qëllim uljen e kostove shtesë për realizimin e shërbimit.

2.3.5 Duke patur parasysh natyrën e shërbimeve që kerkohen operatori ekonomik duhet te ushtroje aktivitetin brenda territorit te Bashkise Finiq. Per te vertetuar kete dihet te paraqese dokumentin e pronesise/apo kontraten e qerase te objektit ne te cilin ushtron aktivitetin e tij, te shoqeruar me planvendosjen perkatese.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e e ambijentit të mesiperm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:

- Dokumentin e pronesise te shoqeruar me planvendosjen perkatese
- Kontraten e qerase, shoqeruar me dokumentin e pronesise, te shoqeruar me planvendosjen perkatese

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij në Territorin e Bashkisë Finiq.

Disponimi minimalisht i 1 (një) ambjenti ku ushtron aktivitetin e tij, lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri dhe garanci për AK që ofertuesi ka kapacitetet e domosdoshme për të përmbushur me sukses kontratën, në kohë dhe konform specifikimeve teknike të kërkuara.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Automjet transporti me kapacitet mnbajtes jo më pak se 1(një) Ton për rastet kur automjetet e AK pesojnë difekte , ndodhen larg servisit të OE dhe kanë të nevojshme asistencën teknike.Për këte OE duhet të paraqese Aktin e pronësisë së mjetit perkatës;Ose Kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës tëpronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale.Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore .
- Disponimin e 1 (nje) ure ngritëse. Mjete te lehta
- Vinç ure me kapacitet ngrites ja me pak se 3 ton per sherbimet ndaj mjeteve te renda.
- Aparat per matjen dhe karikimin e baterive.
- Aparate saldim perçinimi.
- Motokompresor ajri.
- Pompe grasatimi.
- Operatori Ekonomik për të realizuar kontratën duhet të disponojë Ambiente (ndërtesë+ambjente suportuese) me një sipërfaqe të përgjithsme prej jo më pak se 100 m2 .
- Presë për montimin e bokollave, kushinetave.
- Paisje per saldime hekuri dhe saldime me oksigjen.
- Kriko ngritje-ulje kamjo.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit;b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a)dokumentit qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshmëm). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimimit ose faturat tatimore te blerjes.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës që prokurohet dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas formularit përmbledhës së vetdeklarimit.
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, “..Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi.

Duke vlerësuar proceset e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes, disponimi i këtyre paisjeve, lidhet ngushtësisht me realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, duke krijuar garancinë e AK se oferteusit disponojnë pajisjet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës/ave, që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër. Specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara në zërat e riparimit të kërkuara në preventiv.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e prokurimit:

LOTI 2 : “PJESË KËMBIMI, GOMA DHE BATERI PËR MJETET E RËNDA”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.2 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare 2022, 2023, 2024 në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon (të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar), në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij financiar-ekonomik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me*

*përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon, në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij teknik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 55 dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 55 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Licence profesionale Kodi VII.3.B.1” të lëshuar nga Qendra Kobetare e Biznesit (QKB) për veprimtarite:

VII.3.8.1/a – Riparim dhe mirembajtje e pjeseve mekanike dhe te motorit, te mjeteve.

VII.3.8.1/b – Riparim dhe mirembajtje e karrocere ,te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.8.1/c – Riparim dhe mirembajtje e impiantit elektrik te mjeteve rrugore me motore dhe rimorkiove.

VII.3.8.1/ç – Riparim dhe mirembajtje e gomave te mjeteve rrugore me motore dhe rimorkiove.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe në zbatim të Ligjit Nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, neni 4, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, duke siguruar AK që shërbimet objekt prokurimi do të realizohen nga subjekte që respektojnë legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor dhe për normat e kujdesit ndaj mjedisit, ndaj ndotjeve dhe parandalimit të dëmtimeve dhe që janë të regjistruara sipas këtij ligji.

Licenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter më sipër është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 2 (dy) persona, për periudhën muajin e fundit vërtetuar me:

c. Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën muajin e fundit.

d. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkoet nga legjislacioni në fuqi për periudhën muajin e fundit shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat

“a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Sa i perket numrit te punonjesve, kjo kërkesë është shumë minimale dhe e lidhur ngushte me nevojën e përballimit te mbajtjes ne gatishmëri te mjeteve. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personeli i nevojshem referuar shërbimeve të nevojshme për automjetet , për realizimin e kontratës në mbështetje të dispozitave të sipërpermendura sepse nëpërmjet këtij kriteri bëhet përcaktimi nga ana e operatorit ekonomik e listës së personelit të nevojshëm dhe të domosdoshëm që do të ndjek zbatimin dhe realizimin e kontratës, në përputhje me specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit për mjetet në rastet e difekteve nga adresa e autoritetit kontraktor deri në servis, si dhe të pjesëve të këmbimit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Duke qenë se autoriteti kontraktor nuk disponon mjet për transportin e tyre në rast difekti, dhe me qëllim uljen e kostove shtesë për realizimin e shërbimit.

2.3.5 Duke patur parasysh natyrën e shërbimeve që kerkohen operatori ekonomik duhet te ushtroje aktivitetin brenda territorit te Bashkise Finiq. Per te vertetuar kete dihet te paraqese dokumentin e pronesise/apo kontraten e qerese te objektit ne te cilin ushtron aktivitetin e tij, te shoqeruar me planvendosjen perkatese.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e e ambijentit të mesipër në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjitha dokumentacionin provues si me poshte:

- Dokumentin e pronesise te shoqeruar me planvendosjen perkatese

- Kontraten e qerase, shoqeruar me dokumentin e pronesisë, të shoqeruar me planvendosjen perkatese

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij në Territorin e Bashkisë Finiq.

Disponimi minimalisht i 1 (një) ambjenti ku ushtron aktivitetin e tij, lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri dhe garanci për AK që ofertuesi ka kapacitetet e domosdoshme për të përmbushur me sukses kontratën, në kohë dhe konform specifikimeve teknike të kërkuara.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Automjetet transporti me kapacitet mnbajtes jo më pak se 1(një) Ton për rastet kur automjetet e AK pesojnë difekte , ndodhen larg servisit të OE dhe kanë të nevojshme asistencën teknike.Për këtë OE duhet të paraqese Aktin e pronësisë së mjetit perkates;Ose Kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës tëpronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale.Për mjetet që shënohen në regjistra publike (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore .
- Disponimin e 1 (nje) ure ngritëse. Mjete te lehta
- Vinç ure me kapacitet ngrites ja me pak se 3 ton per sherbimet ndaj mjeteve te renda.
- Aparat per matjen dhe karikimin e baterive.
- Aparate saldim perçinimi.
- Motokompresor ajri.
- Pompe grasatimi.
- Gropa cope 2 per riparimin dhe kontrollin e mjeteve te tonazhit të madh me gjatësi jo më të vogël se 10 ml.
- Operatori Ekonomik për të realizuar kontratën duhet të disponojë Ambiente (ndërtesë+ambjente suportuese) me një sipërfaqe të përgjithsme prej jo më pak se 500 m2 .
- Presë për montimin e bokollave, kushinetave.
- Paisje per saldime hekuri dhe saldime me oksigjen.
- Kriko ngritje-ulje kamjo.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:

- g) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerash/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- h) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- i) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës që prokurohet dhe afati i saj.
- j) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- k) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas formularit përmbledhës së vetdeklarimit.
- l) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, “..Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi.

Duke vlerësuar proceset e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes, disponimi i këtyre paisjeve, lidhet ngushtësisht me realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, duke krijuar garancinë e AK se oferteusit disponojnë pajisjet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës/ave, që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadrer. Specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara në zërat e riparimit të kërkuara në preventiv.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posaçme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.